REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

| Pranuar - Primljeno Më/Dana 30-04-2024 vit.god. | | | |
|---|---|---|---|
| Nr.i organit Org.broj | Numri/Broj | Shtojcë Prilog | Vlera Vrednost |
| 01- | 110 | 05- | 670 |

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Kuvendi i Komunës së Vitisë në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, neni 40, paragrafi 40.2, pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 të Kuvendit të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare Nr.28/2008), neni 2 dhe 4 i Ligjit për financat e pushtetit lokal Nr. 03/L-049, nenit 35, paragrafi 35.2, pika b të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më datën 29.04.2024, miraton këtë:

# V E N D I M

**Për aprovimin për bartjen e Mjeteve nga një projektë në projektet tjera në shumë prej (148.376,16) Euro**

1. Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për Bartjen e Mjeteve nga një projektë në projektet tjera në shumën prej (148.376,16) Euro.

2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi, janë projektet:
a) Ndërtimi i rrugëve me zhavor, kodi i projektit 53847 në shumën prej (88.376,16) Euro.
b) Ndërtimi i ujësjellsit në fshatrat: Ramjan, Novosellë, kodi i projketit 52800 në shumën prej (60.000,00 )Euro.

3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i Komunës së Vitisë, Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.

4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrim të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8 lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për Procedurat e Hartimi dhe Publikimi të Akteve të Komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

## A R S Y E T I M

Kjo bartje e mjeteve bëhet për arsye se kompanitë punë kryese kanë ecur me punime më përpara dhe me qëllim që të përmbushimi obligimin tonë të pagesës brenda afati ligjore prej 30 ditëve, mjetet barten nga kategoria ekonomike e investimeve kapitale, kodi i projektit 90552 participim në projektet me donatorët andaj kërkojmë që të lejohet kjo bartje e mjeteve të lartëcekura.

Vendimi u dorëzohet:
1. Zyrës së Kryetarit;
2. Drejtori për Financa
3. MAPL-së
4.Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
K R Y E S U E S I
Bekim Azizi